REPUBLIKA E KOSOVËS•REPUBLIKA KOSOVA•REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT•OPŠTINA UROŠEVAC•MUNICIPALITY OF FERIZAJ
http://kk.rks-gov.net/ferizaj

KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

| | |
|---|---|
| DATA/DATUM/DATE | 13.01.2026. |
| 01 NR/BR. | 07/26 |

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO | Kuvendin e Komunës |
| PËRMES/PREKO/RTHROUGH | Komitetit për Politikë dhe Financa<br>Kryesuesit të Kuvendit të Komunës<br>Xhavit Zariqi |
| NGA/OD/FROM | Kryetar i Komunës<br>z. Agim Aliu |
| LËNDA/PREDMET/SUBJECT | **Propozim Vendim për emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete** |

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika e. lidhur me nenin 61 paragrafi 3 të Ligjit, Nr. 03/L -040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.4, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, si dhe nenit 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 02/2020, për Procedurat e Emërimit të Nënkryetarëve në Komuna, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

## PROPOZIM – VENDIM

### Për emërimin e z. Jeton Emini - Nënkryetar i Komunës për Komunitete

### A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L -040, për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 02/2020 për Procedurat e Emërimit të Nënkryetarëve në Komuna, emërimi dhe shkarkimi i Nënkryetarit të Komunës për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë.

Edhe në rast kur përqindja është më e vogël se 10% emërimi i Nënkryetarit të Komunës për Komunitete nga radhët e komuniteteve jo shumicë, mund të bëhet pas marrjes së vendimit nga Kuvendi i Komunës.

Andaj propozoj që ky propozim vendim si e tillë të miratohet.